# A K T

# T H E M E L I M I

I

SHOQËRISË ME

PËRGJËGJËSI TË

KUFIZUAR

**"Futura Energy" SHPK**

# A K T   T H E M E L I M I

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**"Futura Energy" SHPK**

Sot më datë 18.03.2022, RRASHBULL SHËNAVLASH Vrrinë, Zona Kadastrale 3339, Tokë arë me nr. pasurie 4/48, pranë rrugës së fshatit Rinia, Durrës mbështetur në Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjin Nr. 131/2015 datë 3.5.2007 "Per Qëndrën Kombëtare të Biznesit" dhe në Legjislacionin shqiptar në përgjithësi , u mblodhën ;

1. **Z. Endrit Behari,** i biri i Roland, lindur në Durrës, më 06.12.1980, banues në Durrës, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. B10132931, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Z. Ilir Xhani,** i biri i Xhemali**,** lindur në Durrës, me 27.07.1969, banues në Durrës, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. 031186030, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. **Z. Muharrem Xhani,** i biri i Xhemali**,** lindur në Durrës, me 02.11.1980 , banues në Durrës, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. 028994851, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Të cilët vendosën me vullnetin e tyre të lirë , për krijimin e një shoqërie tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, si dhe përcaktojnë se personat e mësipërm do të jenë Ortakët e saj.

Shoqëria tregëtare me përgjegjeësi të kufizuar do të ketë  të dhëna si me poshtë ;

- Emri i shoqërisë : Futura Energy shpk
- Emërtimi tregëtar : Futura Energy
- Selia e shoqërisë : RRASHBULL SHENAVLASH Vrrinë, Zona Kadastrale 3339, Tokeë arë me nr. pasurie 4/48, pranë rrugës së fshatit Rinia, Durrës

Shoqëria është person juridik Shqiptar, veprimtaria e së cilës rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

- Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me **afat të pakufizuar**. Ky afat mund të shkurtohet me vendim te Asamblesë së Ortakëve.

Shoqëria **"Futura Energy" shpk** gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tillë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

- Shoqëria **"Futura Energy" shpk** do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e:

Projektim dhe ndërtim të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, import eksport i materialeve të lidhura me ndërtimin e impianteve të prodhmit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

➢ Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri dhe jashtë saj. Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është në shumën 100,000 (njëqind mijë ) Lekë e ndarë në 3 (tre) kuota

Kuotat janë të ndara në këtë mënyrë:

1. **Z. Endrit Behari 1 Kuotë me vlerë 33,000 Lekë 33% e kapitalit themeltar**
2. **Z. Ilir Xhani 1 Kuotë me vlerë 34,000 Lekë 34% e kapitalit themeltar**
3. **Z. Muharrem Xhani 1 Kuotë me vlerë 33,000 Lekë 33 % e kapitalit themeltar**

➢ Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave e përfitojne Ortakët e Shoqërisë.

➢ Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqerisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali bazë mund të rritet nga fitimi, në natyrë, ose kredi në lekë ose valutë që merret në Bankë si dhe me kapitale të derdhura nga vetë ortakët.

➢ Fitimet qe do te rezultojnë pas miratimit të bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakëve pas zbritjes së taksave do të ndahen si vijon:

- Fondi rezervë.
- Shpërblimi që i takon Ortakëve themelues.

➢ Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërisë.

➢ Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me ligjin shqiptar ose të huaj.

➢ Në shoqërinë **"Futura Energy" shpk** administrator i shoqërisë do të jetë:

**Z. Endrit Behari,** i biri i Roland**,** lindur në Durrës, më 06.12.1980, banues në Durrës, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. B10132931, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer vetë apo të autorizojë persona të tjerë për të gjitha veprimet për regjistrimin e shoqërisë , në interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

**"Futura Energy" shpk**

**Endrit Behari**

**Ilir Xhani**

**Muharrem Xhani**